

 REPUBLIKA E KOSOVES-VLADA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No. Data Datum Date
5 2	104 21.01.2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku, Tehnologiju i Inovaciju/ Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Datë: 21.01.2022
 Nr. 5-104

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave të nenit 11 paragrafi 3 dhe 4, neni 14 i Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/I-037 si dhe në bazë të neneve 5,6,7,8 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, në bazë të nenit 10 të udhëzimit administrativ (QRK) nr.03/2013 për Standardet e hartimit të akteve normative dhe në bazë të kërkesës nr. 1280 të datës 29.07 2021 për licencim institucional si dhe kërkesës nr. 1280-2 të datës 05.11.2021 për licencim të programit sipas vendimit të AKA të datës 28/10/2021 nr. 3473/21, komisioni merr këtë:

V E N D I M

Për plotësim dhe ndryshim të vendimit nr. 5-1280 i datës 09.09.2021

1. Plotësohet dhe ndryshohet pika 1 e vendimit nr. 5-1280 i datës 09.09.2021 për kolegjin "UBT". si në vijim:
 - 1.1. Bartësit Privat të Arsimit të Lartë, BPrAL/kolegji "UBT", i vazhdohet licenca për programet e studimit, sipas vendimit të AKA, nr. 3031/21 të datës 12.08.2021.
 - 1.2. Licencohet programi i studimit, Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë të nivelit BSC sipas vendimit 3473/21 të datës 28.10.2021 me kohëzgjatje në përputhje me vendimin e MASHTI, nr. 6-2728, datë: 27.09.2019, për Qendrën në Prishtinë.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Në mbështetje të dispozitave ligjore të shënuara më lartë, komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Licencim dhe Rilicencim të BPrAL-ve i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, sipas kërkesës për Licencim Institucional, nr. 1280 datë: 29.07.2021, komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit ka nxjerr vendim me nr. 5-1280 datë: 09.09.2021 ku kolegjit "UBT" i u është vazhduar licenca për programet e studimit sipas vendimit të AKA, nr. 3031/21 të datës 12.08.2021 me kohëzgjatje në përputhje me vendimin e MASHTI, nr. 6-2728, datë: 27.09.2019. Kolegji në fjalë për programin e lartëcekur licencohet për qendrën Prishtinë.

Bazuar në kërkesën e Kolegjit "UBT" me nr. 1280-2 datë 05.11.2021 të plotësuar me vendimin e AKA nr. 3473/21 datë 28.10.2021 për programin e studimit të riakredituar, komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike : Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh te sekretari i përgjithshëm i MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Sekretarit të përgjithshëm, MASHTI;
2. Arkivit të MASHTI;
3. Parashtruesit të kërkesës;
4. DALSHT;
5. DNJBIA;
6. Inspektoratit të Arsimit, MASHTI

Burim Gashi
Kryetar i komisionit për Licencim

